



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Komuna paguan transportin e mësimdhënësve udhëtarë edhe në 2013

21 nëntor 2012, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" këtë javë ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit ka miratuar propozimin e Drejtorisë së Arsimit për shpalljen e tenderit për transportin e 650 mësimdhënësve udhëtarë të Komunës së Prizrenit, të cilët udhëtojnë në relacione të ndryshme brenda territorit të Komunës së Prizrenit, përkatësisht nga Prizreni për në fshatrat e komunës dhe anasjelltas. Vlera e planifikuar nga buxheti i investimeve kapitale nga kjo drejtori, kap shumën prej 160.000 euro, e cila do të përfshijë tërë vitin kalendarik 2013. Sipas arsytimit të DKA, sigurimi i udhëtimit do të ngrit vijueshmërinë në punë, do të ngrit cilësinë e arsimit, por edhe të suksesit sepse mungesat do të jenë shumë më të vogla se sikur të mos sigurohet udhëtimi i mësimdhënësve.

Drejtorisë për Administratë i janë aprovuar kërkesat për formimin e Komisioneve për Vlerësimin e Pasurisë në bazë të nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr. 21/2009, për menaxhimin e pasurisë qeveritare, dhe Inventarizimin e Pasurisë në bazë të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurisë qeveritare.

Ekzekutivi komunal mori konkluzion edhe për hapjen e procedurës tenderuese për studimin e fizibilitetit për Qendrën Sportive "Sezai Surroi", e që duke u mbështetur në Ligjin për Partneritetit Publiko Privat dhe në direktivat që burojnë nga ky ligj, duhet të bëhet një studim i tillë. Pagesa do të bëhet nga pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Kalon edhe propozimi për shpalljen e tenderit për ndërtimin e kompleksit memorial të dëshmorëve në varrezat e Landovicës (parallogaria 260.000 euro).

Në këtë takim është miratuar edhe propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për formimin e komisionit për vlerësimin e automjeteve të konfiskuara që gjenden në parkun e automjeteve të dy operatorëve, vetura këto të konfiskuara nga ana e policisë, që në bazë të ligjeve në fuqi këto vetura duhet tu nënshtrohen procesit të shitjes së tyre me anë të procedurës të Licitacionit publik.

Është dhënë leja edhe për fillimin e përgatitjeve për 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, kërkesë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ku programi dhe agjenda do të përgatitet nga komisioni i themeluar për organizimin e manifestimeve. Gjithashtu, u mbështet edhe filmi dokumentar kushtuar Dëshmorit të Kombit Tahir Sinani, kërkesë e ardhur nga Multimedia "IDEA" (mbështetje financiare me vlerë prej 2500 euro).

Ekzekutivi i komunës në këtë mbledhje ka refuzuar që të miratojë kërkesën e DUPH-së për shpalljen e tenderit për studimin e fizibilitetit në lidhje me legalizimet, me arsytimin se DUPH-ja nuk ka dhënë sqarime konkrete rreth këtij propozimi.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*